

*Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore. 2. Terminologjia e Matematikës dhe Mekanikës teorike (shqip-rusisht-frengjisht). Botim i Sektorit të Terminologjisë të Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë (Universiteti Shtetëror i Tiranës), Tiranë, 1963, 244 f.*

Fjalori i terminologjisë së matematikës e mekanikës teorike është i dyti në serinë e fjalorëve të terminologjisë tekniko-shkencore që janë përgatitur e po botohen nga Sektori i Terminologjisë i Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë.

Matematika është një nga lëndët më të rëndësishme në programet mësimore të shkollave në çdo vend të botës. Në shkollat tona, që nga klasa e parë e fillores e gjer në klasën e njëmbëdhjetë, nxënësit kanë të bëjnë vazhdimisht e përditë me disiplina të ndryshme që përfshihen nga matematika. Kuptohet vetiu pra se me sa rëndësi të madhe ka qënë hartimi i një terminologjie shqipe të matematikës. Kështu shpjegohet edhe fakti që kur më 1948, pranë ish Institutit të Shkencave, disa komisione të posaçme filluan një punë për hartimin e terminologjive të ndryshme shkollore, më mbarë vajti puna për terminologjinë e matematikës, duke u botuar më 1949 492 terma frëngjisht e shqip<sup>1</sup>. Shumë prej këtyre termave si *brinjë, kënd, mbledhje, pjesëtim, rrënjë, shumëzim, trekëndësh, thyesë, vlerë, zbritje* etj. etj. kanë qënë krijuar e përdorur që më parë prej autorësh të ndryshëm të librave shkollore të aritmetikës, algjibrës e gjeometrisë.

Por për mjaft koncepte matematike përdorshin shpesh herë dy ose tre terma, krijuar në kohë të ndryshme e prej autorësh të ndryshëm; për mjaft koncepte të tjera përdorej fjala e huaj, zakonisht frëngjishte, pa u bërë përpjekje për ta shqipëruar. Kështu që atij komisioni i është dashur të bëjë një punë të veçantë sidomos për njësimin e terminologjisë ekzistuese dhe për pastrimin e saj nga ngarkesa e tepërme me fjalë të huaja. Veç kësaj, më 1948, kur vendi ynë kishte një Institut të lartë Pedagogjik dyvjeçar, delte nevoja të përdorshin edhe terma që nuk kishin qënë përdorur më parë. Pra, më 1955, kur puna për hartimin e terminologjive shkencore e teknike rifilloi në shkallë të gjerë e në një mënyrë më të organizuar, Sektori i Terminologjisë që u ngrit pranë Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë, vetëm për terminologjinë e matematikës gjeti një bazë të mirë ku mund të mbështetej për të mos e nisur punën ab ovo. Por ndërkaq, zhvillimi i vrullshëm i ekonomisë, ndërtimi i kombineve, fabrikave, hidrocentraleve, hapja e Instituteve të larta më 1951 dhe e Universitetit më 1957 e bënë të nevojshme që terminologjia e re e matematikës të përfshinte një numër sa më të madh termash për t'ju përgjigjur plotësisht nevojave të prodhimit, ndërtimit e shkencës.

Terminologjia e re e matematikës dhe mekanikës teorike përfshin një numër mjaft të madh termash — 3467. Nën termin shqip jepet

1) Buletin i Institutit të Shkencave, viti III, 1949, Nr.1

kurdoherë termi ruisht e frëngjisht dhe pas fjalorit janë vendosur treguesi i termave ruisht e treguesi i termave frëngjisht, të cilët e lehtësojnë mjaft përdorimin e këtij fjalori.

Që në fillim mund të thuhet se komisioni hartues i përbërë prej gjuhëtarësh e matematikanësh ja ka dalë në krye me sukses punës që kish marrë përsipër. Në këtë komision kanë punuar Q. Turdiu e P. Pilika dhe gjuhëtarët A. Xhuvani, A. Kostallari, E. Çabej, L. Dodbiba, M. Domi. Kjo e ka burimin te bashkëpunimi i ngushtë midis gjuhëtarëve e matematikanëve dhe te zbatimi i të pesë kritereve që janë parashtruar në parathënie (fq.7) : «1) Të çfrytëzoheshin sa më shumë mundësitë e mëdha që ka gjuha jonë për fjalë-terma dhe prirja që ka marrë vetiu zhvillimi i gjuhës letrare në kohën tonë. 2) Të çfrytëzoheshin sa më shumë e sa më mirë mënyrat e tipat më produktivë të formimit të fjalëve në gjuhën e sotme shqipe. 3) Të shqipëroheshin termat shkencore jo ndërkombëtare, duke quajtur ndërkombëtarë ata terma që i kanë të përbashkët jo vetëm dy ose më shumë gjuhë neolatine, siç është vepruar kryesisht në të kaluarën, por që i kanë edhe gjuhët e tjera. 4) Të rivlerësoheshin sa qe e mundur disa terma të vjetër të përdorur qysh në kohë të Rilindjes dhe të braktisur më vonë. 5) Të kihej kurdoherë parasysh përhapja dhe përdorimi i një termi si në shkollë, ashtu dhe në degët e ndryshme të prodhimit.

Është një kënaqësi të konstatohet se gati 55% e termave të këtij fjalori janë fjalë shqipe, duke përfshirë këtu edhe shumë huazime të vjetra e të reja, por që kanë hyrë në fjalorin aktiv të masave, p.sh. (i.e) *afërishëm* affine, *anasjellë* inversion, *barasi* égalité, *bator* facteur, *bosht* axe, *element* élément, *forcë* forcé, *lakesë* courbure, *lakore* courbe, *lavjerës* pendule, *ndryshor* variable, *rikumbim* résonance, *veçim* séparation, *vidë* vis, *zanafillë* origine etj.; 23% janë termat me dy gjymtyrë, nga të cilat njera është fjalë shqipe si *abshisë* vijëdrejtë abscisse rectiligne, *afërsirë* homeomorfe voisinage homéomorphe, *bosht* i kosinuseve axe des cosinus, *kon drejtkëndor* cone orthogonal, *sipërfaqe normopolare* surface normopolaire, *thyesë* rationale fraction rationnelle etj., kështu që termat e huaj, duke numëruar këtu edhe ata që janë bërë ndërkombëtarë, si *abak*, *brahistokron*, *formulë*, *identik*, *logaritëm*, *vektor* etj., zënë vetëm 22% në përbërjen e këtij fjalori. Ky është një sukses i shënuar në punën e komisionit hartues dhe një dëshmi bindëse se shqipes nuk i mungojnë mjetet për t'u bërë edhe gjuha e një shkence kaq abstrakte e kaq ekzakthe siç është matematika.

Për shqipërimin e termave të huaja është përdorur gjerësisht kalimi. Disa herë kuptimi prej termi i fjalës frëngjishte ose ruishte i është dhënë fjalës përgjegjëse shqipe (Bedeutungsentlehnung), p.sh. *almis* instrument, прибор, инструмент; *bërthamë* fr. noyau, rus. ядро; *bërryl* fr. coude, rus. входящий угол; *ugol*; *cak* limite, предел, лимит; *çift* couple, пара, парасил, момент, *fikat* (em) (s')amortir, (s')éva-pouir, успокоить(-ся) (амортизировать-ся), *fuqi* puissance, степень, мощност; *lëmë* domaine, поле; *qokë* repère, репер, метка; *rend* ordre, пбрядок; *trafsh* plan, плоскост, план; *reze* rayon, радице; *rrënjë* racine, корень; *shenjë* signe, знак; *shtëllisje* développement, évolution, развертывание; развертка; *trup* corps, тело корпус; *udhë* trajectoire, chemin, путь, траектория; *varg* succession, suite, следование, последовательност; *vatër* foyer, фокус; *zanafillë* origine, начало; *zhduk* éliminer, исключать; устранять etj.

Për të dhënë shqip një numër të madh termash të huaja janë krijuar shumë fjalë të prejardhura e kompozita më fort pas modelit

të frëngjishtes (Übersetzungslehewörter), por ndonjëherë edhe duke u nisur drejt nga kuptimi i termit, pa ndjekur ndonjë model të huaj. Është shfrytëzuar sidomos prejardhja me prapashtesa, duke u krijuar në këtë mënyrë shumë fjalë-terma të reja mjaft të goditura, p.sh. -azi çiftazi çift pairment pair, четно-четный; -esë duresë tolérance, допуск; lakesë courbure, кривизна; ndërpresë intersection, засечка, ndryshesë variantion, вариация; перемена, изменение; -ës fletës dypolesh feuillet de doublets, листок биполюсов; herës quotient, частное, коэффицент; hypës ose ngjitës ascendant, восходящий; njëvlerës équivalent, эквивалентный; ësi dypolarësi bipolarité, дуполярность; ngulmësi téna-cité, вязкость, устойчивость; njëvlerësi équivalence, эквивалентность; -ëz drejtëz droité, прямая, прямая линия; fijëz e ndërmetme fibre moyenne, среднее нейтральное волокно; -i barasi égalité, равенство; denduri frequence, частота; dredhëti sinuosité, извилистность; gjani amplitude, амплитуда; lugëti concavite, вогнутость, mysëti convexite, выпуклость; veshtulli viscosité, вязкость; -im barazim équation, уравнение; veçim séparation, отделение, выделение; -je fikatje ose venitje amortissement, évanouissement, успокоение, амортизация; shtëllisje évolution, разврëтивание; -or dallor discriminant, дискриминант; përftor générateur, генератор; -ore lakore courbe, кривая; mesore médiane, медиан; ndryshore variable, переменная; ruazore chapelet, непрерывный Ряд; a-së shtysë impulsion, импульс; thyesë fraction, дробь, часть; -tar harkshimtar arc supplémentaire, попольнительная; дуга; kundërshimtar antissupplémentaire, антипопольнительный; -zë trizë triade, триада etj. Termat e formuar me anë parashtesash janë më të pakë. Ja disa prej tyre: çformim déformation, деформация; mbioskulim surosculation, свэрхсоприкосновение; mbishpejtim suraccélération, свэрхускорение ndërkëmbës pëdal, подовшенный; ndërlidhuri corrélation корреляция; ndërshitie interpoler, итерполировать; pabarasi iné-galité, неравенство; palidhuri incohérence, несвязность; papjestueshmërt indivisibilité небелимость; përdëftoj démontrér, доказывать; perkëmbim permutation, перестановка, përvendosje arrangement, размещение; rikumbim résonance, резонанс. Por, pas fjalëve të prejardhura me anë prapashtesash vendin e dytë për nga sasia e zënë kompozitat si p.sh. baraslagesë équidistance, равное расстояние; baraspeshë équilibre, равновесие; bashkëbator cofacteur, сомножитель; bashkëqendror concentrique, коицентрический; dhjetëfaqësh décaèdre, десятигранник, dendësimatës densimètre, денсиметр; dybrirësh bicorné, двурогий; gjysmëbosht demi-axe, полуось; gjysmërrafsh semi plan полуплоскость; nënrrënjës radicante, подкоренное количество; njëtrajtësoj uniformiser, выравниват; qendërikës centrifuge, центробежный; qendërsynues centripète, центростремительный; shumëfish multiple, кратное число; tejçoj transmettre, передавать tejrrafsh hyperplan, свэрхплоскость; i tjetëranshëm al terne, противоположащий; etj .

Disa shprehje-terma janë dhënë shqip duke u përkthyer fjalë për fjalë prej frëngjishtes ose prej ruishtes (Lehnübersetzung), p.sh. emëru-esi më i vogël i përbashkët le plus petit dénominateur commun, общий наименьший знаменатель; ngre në katror élever au carré, возвышат в квадрат; nxjerr rrënjën extraire la racine, извлекать корень; sjellje e harkut në kuadrant të parë réduction d'un arc au premier quadrant, приведение дуги к первому квадранту; sjellje n'absurd réduction a l'absurde, приведение к абсурду; sjellje në zero remise à zéro, приведение к нулю; shkoj drejt... tendre vers... стремиться к...;

*ul shkallën e një barazimi* abaisser le degré d'une équation, понизить степень уравнения; *zhdukje me zëvendësim* élimination par substitution, исключение при помощи подстановки, etj.

Puna që ka bërë komisioni i këtij fjalori ka vlerë në mjaft raste edhe për fusha të tjera të dijës e sidomos për gjuhën e shtypit. Gjejmë në këtë fjalor mjaft neologjizma e fjalë shqipe të rralla që kanë zëvendësuar një numër jo të vogël fjalësh të huaja, të cilat, për fat të keq, vazhdojnë të përdoren ende nëpër faqet e shtypit tonë. Të tilla janë: aksion-shq. veprim, diferencë-shq. ndryshim, elementar-fillestar, eliminim-zhdukje, kalkuloj-njehsoj, korelacion-bashkëlidhuri ose ndër-lidhuri, linjë-vijë, manivelë-dorak, korespondues-përgjegjës, plan-rrafsh, presion-trusni, probabilitet-gjasë, reaksion-kundërveprim, relacion-lidhje, respektiv-përkatës, sekondar-dytësor, tension-ndemje, transmetoj-tejçoj, variacion-ndryshesë, universal-i gjithësishtëm etj.

Ashtu si për hartimin e një fjalori terminologjik edhe për një recensim të tij ndihma e specialistëve të lëndës përkatëse është një kusht i domosdoshëm. Prandaj dëshëroj të falënderoj shokun Mina Naço, pedagog i matematikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, për ndihmën që më dha në hartimin e këtij recensione me vërejtjet e sqarimet e tij shumë të vlefshme. Është e kuptueshme që në këtë fjalor me një numër kaq të madh termash të ketë edhe disa mungesa e të meta. Së pari duhet thënë se kanë mbetur jashtë një numër termash jo të parëndësishëm, të cilët janë te terminologjia e vitit 1949, p.sh. annuler, antiperiode, discussion, élever à la puissance, énumération, équation exponentielle, equation simultanees, fraction complexe, fraction simple, fraction apparente, indice, a prime, a second, a tiers. Këtyre mund t'u shtojmë edhe disa të tjerë si géomètre, геометр (në kuptimin e dijetarit që merret me gjeometri e jo te gjeometrit), старший, старший член, старшая производная; mungon emri abstrakt për кратность (term që përdoret shpesh në matematikë), ndonse janë futur termat кратное число, multiple-shumëfish; общее кратное, commun multiple-shumëfish i përbashkët. Duke u nisur prej këte, do të ish fare e natyrshme që кратность të thuhet shqip *shumëfishësi*, por ky term është përdorur për многообразие, множество, multiplicité.

Në mjaft raste nuk është ecur me vendosmëri në rrugën e shqipërimin të termave të huaja. Kur affine, аффинный është thënë *i afërishëm*, atëhere pse të mbahet *gjeometri afine*? Pokështu jepet termi *shtrim i planit* rabattement du plan, совмещение плоскости, kur *plan* është zëvendësuar me *rrafsh*, duke hyrë kjo fjalë në përbërjen e shumë termave të tjerë si *rrafsh horizontal*, ~ *i bashkëpuqur*, ~ *i dyfishtë*, ~ *kryesor i plogetisë*, ~ *kryesor zanafille* etj. Në disa terma kompozita si *unikursal* unicursale, уникарсальный unimodular unimodulaire, одномодулярный; *unipolar* unipolaire, однополюсный elementi *uni* mund të zëvendësohet me një ashtu siç është zëvendësuar me одно në termat përkatës rusisht.

Ndonjëherë krahas termit shqip është ruajtur pa nevojë edhe termi i huaj, si p.sh. *pesëkëndsh* - *pentagon*, *pentagonal*; *i anaprapët* - *retrograd*; *rikumbim* - *rezonancë*, *rrjedhim* - *koralat*, *trifaqësh* - *trieder* etj.

Ka disa terma kompozita ose fjalë të prejardhura që mund të kritikoheshin nga pikëpamja e formimit të tyre. Kështu ndajfolja *baras* në disa kompozita është përdorur pa bashkëtingëlloren fundore, p.sh. *barabrinjës*, *barakëndësh*, *i barakohshëm*, *barakrahës*, kurse në disa të

tjera del në trajtë të plotë: *i barasfuqishëm, baraslargesë, i baraslarguar, baraspeshë, baraspeshim, baraspeshoj*. Veç kësaj shihet se te *barabrinjës* équilatéral, равносторонний e te *barakrahës* isocèle, равнобедреный gjymtyra e dytë e përsëritjes është një emër i prejardhur me prapashtesën -ës, kurse te *barakëndësh* kemi trajtën e rrjedhore së pashquar shumë të emrit kënd. Lidhur me këtë konstatim mund të bëhen vrejjet e mëposhtme. Së pari, nuk shohim asnjë arësye që të mos thuhej *barakëndës*, kur është thënë *barabrinjës* e *barakrahës* ose që të mos thuhej *barabrinjësh* e *barakrahësh*, kur është thënë *barakëndësh*, për të ndjekur kështu një mënyrë të vetme fjalëformimi. Së dyti, prapashtesa -ës te *barabrinjës* e *barakrahës* nuk është përdorur me kuptimin e saj të zakonshëm, sepse dihet që kjo prapashtesë shërben për të formuar prej emrash e foljesh emra vepronjës (gjakës, shpifës), emra që tregojnë një vegël (petës), disa etnika (vëndës, ardhës) e disa mbiemra, por vetëm me kuptimin veprues si ndihmës (= që ndihmon), rrenës (= që rren) etj.<sup>1</sup>, pra jo me kuptimin e kompozitive tona *barabrinjës* e *barakrahës*. Ky gabim nuk është përsëritur më vonë, kur termat orthoaxial ортоаксиальный, orthogonal, прямоугольный janë bërë shqip *drejtboshtor, drejtkëndor* e jo *drejtboshtës, drejtkëndës* a *drejtkëndësh* siç mund të pritej, po të ishte ndjekur rruga e parë.

Por si *barakëndësh* ka edhe disa terma të tjera kompozita p.sh. *dybrirësh* bicorné, двурогий, *dyfaqësh* dièdre, двугранный; *dygjymtyrësh* binôme, бином, двучлен; *shumëfaqësh* polyèdre, многогранник etj. me gjymtyrë të dytë një emër në rrjedhore shumë të pashquar e me gjymtyrë të parë një numëror ose një përemër të pakufishëm numëror. Këto kompozita janë përdorur me vënd për të dhënë shqip kompozitat e huaja të formuara prej një numërori a një përemri numëror e prej një mbiemri. Në to, për analogji me emrat që dalin në shumë me -ë, edhe emrat e tjerë e kanë ndruar mbaresën *e, a* të shumës në -ë, p.sh. *barakëndësh* (shm. kënde), *dyfaqësh* (shm. faqe) etj., duke dalë kështu -ësh si një formant mbiemëror që po i shkëput lidhjet me mbaresën -(ë)sh të rrjedhore shumë<sup>2</sup>

Prapashtesa -ësi, me të cilën janë formuar shumë terma të reja, më ndonjë rast nuk është përdorur në pajtim me rregullat e fjalëformimit, shqip. Kjo mund të thuhet p.sh. për termat *pabashkëmatësi* incommensurabilité, несоизмеримость; неизмеримость, *dykuptimësi* ambiguïté, двухсмысленность. Dihet se prapashtesa -ësi shërben për të formuar emra abstraktë e kolektivë prej emrash e mbiemrash<sup>3</sup> por te *pabashkëmatësi* kjo prapashtesë i është ngjitur një teme foljore. Për të krijuar emrin abstrakt në këtë rast duhet nisur nga mbiemri i *pabashkëmatshëm*, dhe siç dihet, emrat abstraktë prej mbiemrave në -shëm formohen me anë të prapashtesës -ëri, pra: *pabashkëmatshmëri*.

1) Shih: A. Xhuvani, E. Çabej «Prapashtesat e gjuhës shqipe» Tiranës 1962, f. 42v.

2) Kompozitat në fjalë përdoren si mbiemra të substantivuar, në trajtën e gjinisë mashkullore (shih shembëllat më lart) ose femërore (si p.sh. *dylekëshe* etj.). Është për t'u venë re këtu se prapashtesa -e vjen pas mbaresës -sh, ndërsa dihet që për gjuhët indoeuropiane shumë rrallë një prapashtesë mund të rrijë pas një mbarese. Kjo është një provë që -sh aty nuk ndjehet më si mbarese, por si një formant fjalëformues. (Shih për këtë: A. Kostallari, «Mbi disa veçori të

Pokështu edhe termi *dykuptimësi* duhej të ishte *dykuptimshmëri*, pasi është fjala për vetinë e të qenit i dykuptimshëm, kurse emri abstrakt *kuptimësi*, i dalë prej një emri tjetër abstrakt *kuptim* (ndërkaq te shëmbëllat për prapashtesën *-ësi* në veprën e cituar të A. Xhuvanit e E. Çabej nuk ka asnjë emër të formuar më këtë prapashtesë prej një emri abstrakt), nga analogjia me *mal - malësi* etj. të jep idenë e një tërësie kuptimesh, pra merret si një emër përmbledhës. Termi terme *extreme*, *крайний член* është thënë shqip *kufizë e skajëshme*, por dihet se mbiemrat me *-shëm* tregojnë një cilësi të rrjedhur nga të pajisurit me një gjë ose me një veti<sup>1</sup>, pra e *skajshme* do të kuptohej si «që ka skaj» (khs. e fuqishme = që ka fuqi) dhe jo «që është në skaj». Për këtë arsye në vend të *kufizë e skajshme* duhej thënë *kufizë skajore*. Termi *гуп forcash njësi* përkthyer nga frëngjishtja tube de forces unité ka dalë i paqartë në shqipen, prandaj në këtë rast duhej nisur nga rasishtja *трубка единицы силы* shqip «гуп i njësisë së forcës». Ka edhe disa raste të tjera në të cilat komisioni duhej të nisej jo nga termi frëngjisht, por nga termi rasisht që ka hyrë në përdorim nëpërmjet teksteve të ndryshme sovjetike të përdorura te ne. Kështu do të respektohej kriteri i të pasurit parasysh te përhapjes e përdorimit të një termi, që është parashtruar në parathënietë fjalorit. Si shembëll po sjellim termin *gjini e pafund* bërë shqip pas frëngjishtes *genre infini*; ndërkaq në universitet përdoret *seri e pafund* pas rasishtes *бесконечный ряд*. Në parim nuk është e drejtë që për hartimin e një terminologjie shqip të nisemi gadi gjithmonë vetëm prej një terminologjie të huaj, qoftë kjo frëngjisht, rasisht, inglisht, gjermanisht ose italisht. Kur është fjala për terma që nuk kanë zënë vënd mirë ose që nuk kanë filluar ende të hyjnë në përdorim, shqipërimi i tyre duhet bërë duke u nisur nga ajo gjuhë ku fjala-term e shpreh më saktë konceptin e saj. Është një tjetër gjë pastaj se veç shqipes, në sa gjuhë e në cilat gjuhë do të jepen termat e mbledhura në fjalor. Kjo diktohet nga rrethana të ndryshme. Zgjedhja e frëngjishtes dhe e rasishtes për fjalorët terminologjikë shqip përligjet nga fakti se në këto dy gjuhë janë përgatitur shumica e kuadrove shkencore të vendit tonë dhe se frëngjishtja për një kohë të gjatë ka luajtur rolin e një gjuhe ndërkombëtare të shkencës, artit, diplomacisë etj. Veç kësaj pjesa më e madhe e literaturës shkencore që gjëndet në vendin tonë është në këto dy gjuhë e sidomos rasisht.

Parimi i terminologjisë që për një koncept të ketë vetëm një term është shkelur më ndonjë rast. Këtu nuk kemi parasysh ato raste kur veç termit shqip është mbajtur dhe termi i huaj si *trifaqësh-triedër*, por rastet kur për një term të huaj janë përdorur dy fjalë shqipe të ndryshme p.sh. te termi *hapësirë vende-vende e rrasët espace localement compact*, *локально компактное пространство* me mbiemrin e *rrasët* është dhënë fr. *compact*, rus. *компактное* kurse në një tjetër vend gjejmë termin *i ngjeshët compact. компактный, компакт*. Si ky ka edhe të tjerë. Një gjë të ngjashme kemi edhe te *shtjellje vektori*, *rotationel d'un vecteur*, *вихрь вектора*, por: *shakull* *tourbillon*, *вихрь*; *shakullor* *tourbillonnaire*, *вихревой*; *lëvizje shakullore* *mouvement tourbillonnaire*, *вихревое движение*, *vektor shakullor* *vecteur tourbillon*, *вихревой вектор*, ndërsa duke kërkuar si është thënë shqip *вихревое ускорение* te numri 2945, siç shënon treguesi i termave rasisht, gjë-tëm përkundrazi *shpejtim rrotullor accélération rotatoire* (?) Edhe këtu

shihet se komisioni, duke dashur, pa ndonjë arsye të dukshme, të mbajë për këtë koncept dy fjalë si fr. rotationel e tourbillon e jo një fjalë si rus. вихрь, ka futur në përdorim veç fjalës shtjellje edhe fjalën shkull, të cilën sot çdo njeri e kupton si lëkurë bagëtish të imta për të mbajtur brenda bulmet etj. Kështu fjala shqipe, në vend që ta bëjë më të qartë, përkundrazi e pështjellon kuptimin e vërtetë të termit.

Tani njady vrejte më të veçanta. Te termi *anasjellë* inversion, инверсия prapashtesa -ë ka dhënë një fjalë të re që nuk ka kuptimin e procesit, por të rezultatit, pra duhej *anasjellje* (khs. p.sh. *mbështjellë* enveloppée, огибаемая обчемлемая. Te numri 961 gjejmë *gjysmë-dekaster* demi-décaster, пять степ që është një masë prej pesë metrash kub. Natyrisht pritej që të gjenim edhe *dekaster* e *ster*, por për fat të keq këta dy terma mungojnë. Termi *koha e rrjedhur* temps d'écoulement, время истечения duhet bërë *koha e rrjedhjes*; *vlerë limite*, *vlerë kufitare* valeur-limite, предельная величина sa kohë që fr. limite është thënë shqip cak, duhej bërë *vlerë-cak*; te termi *udhë* trajectoire; chemin; путь, траектория duhej shtuar edhe fjala trajektore ashtu si në termat frëngjisht e rusisht. Më së fundi, do ta njohim si një të metë të fjalorit mungesën e shkurtimeve që përdoren në matematikë e në mekanikën teorike.

Me gjithë të metat e tjera që mund të ketë si një nga të parët në llojin e vet, ky fjalor është një punë me vlerë të madhe për terminologjinë shqipe e për hartimin shqip ose përkthimin e librave të ndryshme të matematikës e mekanikës teorike. Ai po kalon provat e para në praktikën e dhënies së këtyre lëndëve në Universitetin e Tiranës. Pedagogëve të katedrës së matematikës u bie detyra që t'i mbledhin vrejttet që mund t'u dalin gjatë punës për terma të ndryshme e t'i diskutojnë me punonjësit e Sektorit të Terminologjisë të Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë, për të arritur shkallë-shkallë, në saktësimin e termave, duke shmangur kështu të metat e mungesat e kësaj terminologjie me kaq rëndësi. Me këtë rast është me vend të kujtojmë se «gjithë punonjësit që janë të interesuar për daljen e kësaj terminologjie, duhet pra të zhvishen prej çdo paragjykimi dhe përhir të dashurisë që ata ushqejnë për gjuhën amtare, ta zbatojnë këtë besnikërisht në shkollë, në laboratore, në fabrika e punishte» (Parathënia, f. 9)

Emil Lafe

